DEKRET
Nr. 454, datë 5.12.2025

PËR DHËNIE DEKORATE

Në mbështetje të nenit 92, germa "ç", nenit 93 të Kushtetutës, nenit 6, pika 1, të ligjit nr. 93/2022, "Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë", me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1
Dhënien e dekoratës "Oficer i Urdhrit të Skënderbeut"
zonjës Mimoza Dhëmbi (Selmani)

"Në vlerësim të meritave të veçanta dhe të kontributeve të qëndrueshme në shërbim të shtetit dhe të interesit publik, të karakterizuara nga përballimi dhe zgjidhjet eficiente në situata komplekse arbitrazhesh dhe vendimmarrjesh, duke dëshmuar gjatë një veprimtarie shërbimi mbi 20-vjeçare aftësi dhe vizion strategjik në menaxhimin financiar publik".

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj